
	<p style="text-align: center;">Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p style="text-align: center;">Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	
---	---	---

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 23.08.2023 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: “ERZ” shpk lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Ndërtimi i tribunës lindore për stadiumin 2 Korriku - Faza II**”, me Nr. të Prok: **616-23-567-5-2-1**, Autoriteti Publik - Komuna e Prishtinës me datë: **25.08.2023** nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet** kërkesa për ri shqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: ERZ SH.P.K e parashtruar me datë: 13.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Ndërtimi i tribunës lindore për stadiumin 2 Korriku - Faza II**”, me Nr. të Prok: **616-23-567-5-2-1**, kundër *Njoftimit për Kontratë*, të datës **31.07.2023** të publikuar ne web-faqe te KRPP-së , në bazë të nenit 108/A par.8.1. të Ligjit për Prokurimin Publik.
2. Autoriteti Kontraktues, ka përmisuar kriteret me rekomandim të Njësisë Kërkuese lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Ndërtimi i tribunës lindore për stadiumin 2 Korriku - Faza II**”, me Nr. të Prok: **616-23-567-5-2-1**.
3. Autoriteti kontraktues ju njofton që hapja e ofertave bëhet me datë: 06.09.2023
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Andaj në bazë të asaj se çka është cekur në arsyetim, Autoriteti Kontraktues ka vendosur si në dispozitivin e lartcekur.

Iu dorëzohet:

Departamentit të Prokurimit
Palës përmes sistemit elektronik - E-Prokurimi
Arkivit

Visar Shehu - U.D. - Departamenti i Prokurimit

